

Data 15.06.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekësore për ortopedinë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
33141700-7- Furnizime Ortopedike**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Vlore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**Kriteri 2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar me lart, në menyre që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Neni 43 pika 5

---

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore\***, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4/b ku citohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi*

#### **2.3.3**

**a) Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2015 ekuivalent ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimit të cilësive” /ose ekuivalent/ të vlefshme të cilësive për ofertuesin e mallrave objekt i kontratës. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë**

*Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur nuk eshte prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet te paraqese autodeklarate** qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte konform standarteve te cilesise **ISO 9001** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent **ISO 13485** ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise” /ose ekuivalent/ të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

*Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, ose ekuivalent,origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. *Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.**

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit. (e vlefshme vetem per OE lokalë/vendas)**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 2 “ *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohesh në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.” Si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 40 pika 5 a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose**

- **Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;*

- **Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi**

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *njesia e prokurimit* vendosi te njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për përlllogaritjen e fondit limit në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nr	Emertimi	Specifikime
1	PLLAKE KLAVIKULE	Pllake klavikule anatomike superiore anteriore e majte dhe e djathte per vida 3.5mm jo locking me gjatesi 95 – 120 mm me deviacion +/-10%
2	PLLAKE KERCIRI ANATOMIKE	Pllake Kerciri anatomike mediale dhe laterale e majte dhe e djathte me gjatesi nga 80mm-325mm me devijacion +/-10%.

3	PLLAKE FEMURI ANATOMIKE KOMPRESIVE	Pllaka duhet te kete nje gjatesi e cila te varioj nga 118mm deri 330mm me nje deviacion +/- 10%.
4	PLLAKE HUMERUSI ANATOMIKE LOCKING	Pllake anatomike proksimale humeri jo locking e majte / e djathte per vida 3.5mm/4mm me 4 deri 10 vrima e gjatesi 85mm-160mm dediacion +/- 5%
5	PLLAKE ANATOMIKE RADIUSI DHE ULNE	Pllake anatomike Radiusi dhe Ulne me gjatesi nga 92mm ne 242mm per vida 3.5mm me devijacion +/-10%. Pllake anatomike distale volare e majte dhe e djathte me gjatesi 55mm deri 77mm me devijacion +/-10%. Pllake volare distale ekstra artikulare e majte dhe e djathte me gjatesi 47mm dhe 67mm
6	PLLAKE PROKSIMALE FEMURI LOCKING	Pllake anatomike proksimale femuri , te jete e majte e djathte me nje gjatesi 100mm deri ne 350 mm me nje deviacion +/-5%
7	PLLAKE ANATOMIKE PILONI	Pllaka duhet te jete ne formen e terfilit me gjatesi 86mm-205mm per vida 3.5 mm dhe 4.5mm me devijacion +/-10%.
8	Pllake Anatomike Fibule Distale	Pllake 1/3 TUBULARE me gjatesi te ndryshme nga 70 mm deri ne 140 mm me devijacion +/-10
9	Vida kortikale autofiletante 3.5	Vida kortikale auto-filetante 3.5mm me gjatesi nga 8mm – 120mm.me devijacion +/- 10%
10	Vida kortikale autofiletante 4.5	Vida kortikale auto-filetante 4.5mm me gjatesi nga 12mm- 150mm. me devijacion +/- 10%
11	Vida spongiotike auto filetante	Vida spongiotike auto-filetante 4.0mm me gjatesi nga 10mm – 70mm. me devijacion +/- 10%
12	Vida spongiotike auto filetante	Vida Spongiotike auto-filetante 6.5mm me gjatesi nga 25mm – 140mm.GJYSEMFILETO. me devijacion +/- 10%
13	Vida locking	6.5 mm
14	Vida maleolare autofiletante	Vida maleolare auto-filetante 4.5mm me gjatesi nga 20mm – 120mm. me devijacion +/- 10%
15	Vida pa koke (Hebert Screw )	HERBERT SCREW (vida Herbert) VIDA PA KOKE, me devijacion +/- 10%

## SPECIFIKIME TEKNIKE

Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh (kur është e aplikueshme).

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

**Materiali prej të cilit prodhohen artikujt për ortopedinë të jenë TITANIUM.**

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :**

Data: **26.06.2023 Ora: 10:00**

Lëvrimi i Mallit: **Furnizimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, periodikisht sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.**

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e nje kontrate /dorezimin e fatures tatimore duhet të ketë:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesin që përdor Platformën Qëndrore të Faturave /

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës të lidhur me shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesin që lëshon faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

**Njesia e Prokurimit**